REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.04.2026 Prot.54 (pesëdhejtëekatër)

Protokoll nr. 54

I mbajtur sot më datë 30.04.2026, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite :

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë (27.03.2026)
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin mars 2026";
5.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë"
6.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.F.XH banuese në FshatinVelitërnë Nj.A Pirg, banesa e të cilës u dogj si shkak i rënies të zjarrit";
7.P-V "Për ndryshim në buxhetin e bashkisë Maliq për vitin 2026";
8-P-V "Për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga buxheti i shtetit";
9.P-V "Për lehtësimin e përkohëshëm nga detyrimi për pagesën e taksës së tokës bujqësore për familjet bujqësore, toka e të cilave është e përmbytur dhe e pamundur për t'u shfrytëzuar gjatë vitit bujqësor 2026 nga dëmtimet e forcave madhore të natyrës";
10.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i interesave të kredisë për strehim";
11. Analiza e zbatimit të buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2025.
12.Njoftim për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të bashkisë Maliq viti 2025.
13.Diskutime të tjera.

**Këshilltarë të pranishëm në sallë:**

Ornildi Demollari; Klea Baçi;Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Petrit Kupe; Aramando Dautllari; Selami Muço; Kela Baçi; Rovena Terolli; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Enida Avdolli; Andonaq Risto; Dalina Krekas; Neresida Shindo; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Server Xhuti; 18(tetëmbëdhgjetë) këshilltarë.

**Mungesa:** Dritan Çami; Floreta Zaçe; Marinathi Avrami; Idlir Limllari; Almir Elezi; Xhuana Hoxhallari; Eriseld Jonusllari; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Plator Çollaku; Ilia Xhuti; Marjeta Xhelollari; 13 (trembëdhjetë).

**Të pranishëm nga Administrata:** z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka; Drejtore e Shërbimit Social; znj.Ermanda Petriti; Përgjegjës i Zyrës së Strehimit; z.Ledion Mullalli; Përgjegjës i Emergjencave Civile; z.Stiljan Belishta; Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë;z.Arurel Zenunllari.

**Ornildi Demollari:** Mirë fillojmë.Mirëdita të gjithëve, kemi thirur këtë mbledhje e cila përkon të jetë dhe mbeldhja e radhës e Këshillit ashtu si jeni njoftuar dhe disa ditë më parë dhe do të vijojmë mbledhjen nga ekezkutivi po e shoqëron z/v.Kryetari z.Eridion njëkohësisht është dhe drejtoresha e financës dhe specialistë të tjerë, nga sa verifikuam në sallë janë rreth 18 Këshilltarë, kështu që mund të vijojmë.ju ftoj të miratojmë rendin e ditës.Po.

**Eglantina Balli:**Kisha një deklaratë për të lexuar në emër të grupit.

**Ornildi Demollari:**E keni përcjellë, e kemi marrë.Është tjetër?

**Eglantina Balli:**Po.Do e lexoj tani.

Grupi i këshilltarëve të opozitës në Këshillin Bashkiak Maliq denoncon një ndërhyrje të papranueshme të ekzekutivit në kompetencat ekskluzive të Këshillit, duke cenuar hapur ligjshmërinë, ndarjen e pushteteve dhe përfaqësimin qytetar. Në këto kushte, ne shpallim bojkotin e menjëhershëm të mbledhjeve të Këshillit deri në rivendosjen e plotë të rendit ligjor dhe institucional.Arsyet e bojkotit:

1. Uzurpimi i kompetencave të Këshillit Bashkiak nga Kryetari i Bashkisë;

2. Shkelja e ligjit nr. 139/2015 për vetëqeverisjen vendore;

3. Tentativa për manipulim dhe kontroll politik të vendimmarrjes së Këshillit;

4. Cenimi i rolit përfaqësues të Këshillit dhe i demokracisë vendore;

5. Krijimi i një precedenti të rrezikshëm për funksionimin e institucioneve vendore.

6. Vend vakant tek Qarku

7. Zgjedhjet e kryepleqve

8. Mosshkelja e rregullores

Kërkesat tona ja u kemi derguar me përpara, kur te vendosen ne rend dite për zgjidhje te na njoftoni!Në emër të Grupit më të madh Opozitar të Këshillit Bashkiak Maliq, Kryetarja.Eglantina Balli.

**Ornildi Demollari:**Falemdinderit! Dhe që është diçka tjetër, por është e njëjta, ja u kemi dhënë përgjigjen për këtë.Nuk ka sa ndërhyrje në kompetencat e Këshillit as kapje të Këshillit nga ekezekutivi.Kemi sqaruar që gjitha dokumenat që kanë të bëjnë me natyrë juridike do i konsumojmë me zyrën jurdike, sepse ne në Këshill nuk kemi në përbërje juristë, që mund ti ndërtojmë vetë dokumentat me karkter juridik, kështu që përsëris dhe njëherë që nuk ka asnjë kapje të ekzekutivit dhe nuk ndërhyrje në kompetencat e Këshillit.Faleminderit.Largohen nga mbledhja dy këshilltarë përfaqësues të opozitës znj.Eglantina Balli dhe z.Server Xhuti.Në sallë mbeten 16 Këshilltarë, mbledhja mund të vijojë.

**Faslli Zholi:**Përshëndetje të gjithëve këshilltarë. Përshëndetje kryetar i këshillit, përshëndetje nënkryetar i bashkisë. Për sa i përket kësaj deklarate sot e dëgjova se atë të parën e jemi njohur. Për dijeni që këshilli të ketë dijeni të plotë edhe unë jam pjesëtar i opozitës dhe patjetër që do bëj opozitë në këtë këshill. Por më duket një diçka që unë ia kam kërkuar dhe në kryesësi për ato pika që ata kishin bërë deklaratën e parë. Duhet ta këshilli të vendosi, sidomos për çështjen e zgjedhjeve të lokale të kryepleqësisë, e thamë që të caktohet data dhe ato pika që kishin opozita për t'i ashtu t'i shikojmë këtu dhe ta zgjidhim. Edhe për sa i përket edhe vendit vakant që ka qysh një detyrim ligjor që e kishin shkruajtur në atë deklaratën e parë, përsa i përket kësaj jo, nuk e di. Sepse unë kam dalë dhe nga Facebook-u, më kanë nxjerrë nga Facebook-u shokët, kolegët, pavarësisht ashtu që ta dijë edhe këshilli. Nuk më shqetëson ajo dalja nga Facebook-u i këshillit të bashkisë, sepse unë këtu jam fazdiu dhe jam me dinjitetin tim dhe zonjën Nersida që e kam këtu e tjetra është e sëmurë. Ne nuk kemi sensin që të bojkotojmë, por opozitën do ta bëjmë dhe opozitë nuk do ta bëjmë as për falso. Atje ku janë gabimet, unë e kam thënë që në fillim. Këshilli, ato që kemi neve për detyrë si kryesi, si këshill, këtu pa i shikuar dhe ato ne kemi rënë dakord këtu që të bëjmë edhe ca gjëra të përbashkëta. Kur kthejmë të përbashkëta, që t'i shërbejmë komunitetit. Pastaj do vijmë në mbledhje, ose do vijmë në mbledhje, mua këto unë porosi edhe veten time e kam si parti e lirisë, si i zgjedhur që jam edhe në forume drejtues të partisë, e kam që bojkotet nuk janë të mira, nuk janë të shëndetshme. Hajde t'i bëjmë gjërat këtu shesh e shesh. Prandaj kam kërkuar dhe në kryesi, edhe ajo vajza bëri deklaratën e iku. Arsyet ne i kemi kërkuar vazhdimisht ato pika që ashtu ne kemi mundësi që t'i bëjmë. Qoftë zgjedhjet t'i shikojmë. Në Zvezdë i keni bërë zgjedhjet, thashë kërkohet procedurë. Në atë fshatin që ka vdekur ndjesë pas saj, të bëjmë zgjedhjet e kryepleqësisë, pavarësisht se mandati po mbyllet. Mos i nxvarritim këto. Këto janë kërkesa dhe janë të drejtat e opozitës që ka kërkuar. Faleminderit për mirëkuptimin.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit.Ndaleme. Jo, një.

**Nersida Shindo:**Jo, do ta shtoj. Pa kaluar në rendin e ditës.

**Ornildi Demollari:**Po shkoj te rendi i ditës. Do të ndalem pak tek kjo që të kam thënë.

**Nersida Shindo:**Jo, do të bëja një pyetje rreth përgjigjes si dhe koleges që u largua. Tani nuk e kuptoj ku çalon ose ku nuk miratohet me ligj kërkesa që kemi bërë për vendin vakant në këshillin e qarkut. Keni kthyer një përgjigje që nuk ka pala juaj kandidat. Kush e pengon palën tuaj që mos ketë kandidat dhe pse të shtyhet kaq kohë?

**Ornildi Demollari:** Po, a duhet të sjellin të dyja, të gjitha grupet më saktë, më falni?

**Nersida Shindo:** Po, po, kush ju pengon?

**Ornildi Demollari:** A duhet të sjellin, po kush ju pengon? Po thuaj grupit që.

**Nersida Shindo:**Po pse nuk vihet në rend dite atëherë që të diskutohet?

**Ornildi Demollari:** S'kanë sjellë, s'kanë erdhur të gjitha propozimet. Do sjellë dhe maturanca.

**Nersida Shindo:**Jo, vetëm nga ju s'kanë ardhur.

**Ornildi Demollari:**Do sjellë dhe grupi.

**Nersida Shindo:**Propozimet nga grupi opozitar kanë ardhur, nuk kanë ardhur vetëm nga ju.

**Ornildi Demollari:**Duhet të sjellin të gjitha grupet.

**Nersida Shindo:**Po, po pse s'i sillni?

**Ornildi Demollari:** Po tani pyete grupin.

**Nersida Shindo:**Po ka një vit, ka një vit që është vendi vakant. Po jo, tani ju lutem.

**Faslli Zholi:**Tashi problemi është këtu që të mos merremi me këtë. Kjo është një detyrë ligjore e këtij këshilli për ta zëvendësuar. Për ta zëvendësuar atë. Merreni ju, ju sillni kandidaturën tjetër. Ne po të doni t'ju japim dy kandidatura. Një nga grupi i partisë jemi brenda koalicionit, si mesdhenj atje pa, ama kjo punë të merret njëherë e mirë. Le të vejë kush të dojë, nuk ka rëndësi kjo punë, po të zgjidhet. Që të mos jetë premisë që ajo vajza apo unë apo tjetri të bëjmë zhurmë kot. Kjo është e vërteta.

**Pranvera Begolli:** Kryetar, dhe unë e mbështes këtë. Nga pjesa ime ku jam dhe nuk e kuptoj përse ne si mazhorancë nuk japim një emër për të përfaqësuar në këshillin e qarkut.

**Ornildi Demollari:**Po bëni një mbledhje grupi dhe nxirrni.

**Pranvera Begolli:**Po pse? Kjo e pengon mbledhjen e grupit. Tani nuk shkon kështu.Aktualisht duhet të zgjidhet. Me largimin e Rudinës duhet të ksihte, përfaqësuese në këshillin e qarkut.

**Ornildi Demollari:**E kuptova. Tani, për sa i përket dy pikave të tjera që ka kërkuar opozita, për zgjedhjet e kryepleqve dhe për titujt e nderit. Jemi në të njëjtën ngërç në të dyja pikat. Edhe për titujt e nderit kemi ndërtuar një rregullore të re, e cila erdhi njëherë në këshill dhe nuk u miratua. U kthye me arsyetimin që kishte nevojë për amendime të tjera dhe për sugjerime. Ndërkohë, të njëjtën ngërç kemi dhe me kryepleqtë. Edhe tek kjo pikë ka nevojë për t'u rishikuar rregullorja e zgjedhjeve në strukturat komunitare në fshat. Pasi, pasi me këtë rregullore që kemi ecur, jemi në proces gjyqësor pikërisht për këtë punë, për zgjedhjet e kryepleqve. Kështu që këto fshatra që kanë ngelur është mirë që t'i bëjmë me një rregullore të rishikuar. Dhe ndërkohë që rastin t'ju ftoj edhe këshilltarët e mazhorancës dhe të opozitës që rregulloren që kemi ka përfunduar dhe është draft akoma për titujt e nderit, nëse kanë amendime ose sugjerime, t'i sjellin dhe ta futim në mbledhjen më të parë për miratim. Faleminderit.

**Faslli Zholi:**Po ta bëjmë debatin këtu edhe ajo vajza që iku, unë jam katërcipriSht që në qoftë se nuk i pëlqen ai draft që është bërë, hajde ta diskutojmë dhe të ndryshojmë, të vijmë në konsensus dhe ta bëjmë ashtu që t'i shërbejë edhe legjislaturës tjetër. Jo ikim kështu edhe se është bërë, sepse unë e pashë atë, e diskutojmë në kryesi dhe prandaj dua që mos hamë kohën më kësaj mbledhje. E thashë në kryesinë që këto pika t'i regjistrojmë. Nesër në kryesinë t'i nxjerrim, t'i futim në rend dite që kjo punë të mbyllet njëherë e mirë. Janë tre gjëra që të cilat neve është një ngërç që nuk ia vlen ta diskutojmë. Faleminderit.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit.

**Petrit Kupe:** Përshëndetje. Për të tre çështjet që ngre opozita, kanë të drejtë, por këto nuk mund të shtyhen pambarimisht. Siç e dini, kemi hyrë gati në vitin e fundit të mandatit. Ndoshta do mendohet të lihet a të bëhet. Patjetër që këto do të diskutohen, sepse nuk janë arsye themelore për t'u larguar nga këshilli. Duke ditur që raporti numerik është në favor të shumicës. Kështu që në një mbledhje të radhës mos i lëmë arsye që të largohen nga këshilli duke vënë në ndryshim vijueshmërinë e mbledhjeve të këshillit.

**Ornildi Demollari:**Mirë Petrit, faleminderit. Ëh, atëherë, ëh, thashë që realizojmë korumin dhe ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, por.

**Nersida Shindo:**Po përsëris, morëm përgjigje si duhet. Megjithatë, që të jemi një këshill, se ne kërkojmë të jemi këshill model. Këshilli i Maliqit, bashkia kërkon të jetë një këshill model. Ne bëjmë foto, mblidhen komisionet dhe komisioni është i përbërë nga pesë anëtarë dhe foto dalin me dy anëtarë dhe u krye komisioni. Si mund të jemi ne këshill duke u bërë komisionet me dy anëtarë, jo nga pesë që janë, plus që përgjigjet që po i jepni janë shumë të thata. S'e di se s'jemi mbledhur kur të mblidhet grupi. Kur do mblidhet grupi? Kur të mbarojë mandati?

**Ornildi Demollari:**Nersida, unë dhashë tre përgjigje, janë tre çështje. Tani shumë herë, shumë herë përgjigjet s'na pëlqejnë edhe mua vetë shumë herë s'më pëlqejnë përgjigjet, po kjo është përgjigje.

**Nersida Shindo:**Po ty s'të pëlqejnë pastaj ngaqë bën ironi.

**Ornildi Demollari:**Jo, jo. Shumë përgjigje që marrim në jetë s'na pëlqejnë, po.

**Nersida Shindo:**S'ka lidhje me këtë. Nuk është rasti këtu.

**Ornildi Demollari:**Tani këto janë përgjigjet.

**Faslli Zholi:**Kryetar, edhe njëherë, neve këtë vajza e ka mirë, po pastaj edhe për komisionet neve, edhe komisionet unë e kam mirë shokët, që ne mblidhem tre veta, katër veta dhe komisionet jo, është e vërtetë kjo. Edhe kjo është përgjegjësia e çdo këshilltari. Mos e lëmë tashiti këtë, është çdo përgjegjësia e çdo këshilltari e komisionit. Komisioni është komision dhe duhet të vijë në atje siç vija unë, siç vjen dikush tjetër, jo në komision. E para një. E dyta, në kjo mbledhje unë mendoj para se të hyjmë tashit në atëherë ta vendosim një, dy, tre gjëra, të ngremë kartonin dhe kjo do të zbatohet sa më parë që neve mos ngelim. Jam dakord edhe me këshilltarin parafolës, zotin Kupe.

**Ornildi Demollari:**Mirë, faleminderit.

**Pranvera Begolli:**Me lejë, kryetar.

**Ornildi Demollari:**Jo, po ju lutem tashi, se.

**Pranvera Begolli:**Jo, e kam fjalën tek komisioni i thotë Nersida. Përgjegjësia nuk është e këshillit të bashkisë. Përgjegjësia është e çdo këshilltari. E para që në pjesëmarrja.Që nuk vjen, se njëherë në muaj është mbledhja. Se për të futur në listë ulurinë, të jenë aty, në listë biletë të jenë në listën e parë. Dhe e dyta, në komision, derisa t'i kemi në komision, je i detyruar. Njoftimi bëhet cilët komision do të jenë atje kur vihet rendi i ditës dhe të paraqiten. Nuk është përgjegjësi e këshillit ajo. Është përgjegjësi individuale e çdo anëtari bashkiak.

**Faslli Zholi:**Jo, këshilli e ka këtë përgjegjësi të marrë masë ndaj këshilltarit që nuk zbaton rregulloren.

**Ornildi Demollari:**Ju lutem, se u ngelëm peng i kësaj tani. Ju lutem, ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, por, por kanë erdhur dy pika shtesë. Njëra ka të bëjë me festën e fshatit Kolanec dhe e dyta ka të bëjë me një sipërfaqe pyjore në fshatin Plasë, e cila i shkon një kompani për vendosjen e disa pajisjeve për prodhimin e energjisë nëpërmjet erës, apo jo, në mos gaboj, nënkryetar? Se

nuk e pashë.Po pra, nuk ka erdhur së fundi ajo, e ka sekretari dhe nënkryetari. Tani mund t'i shtojmë në rendin e ditës?

**Andonaq Risto:** Këtë të fshatit Plasë unë besoj që ta shikojmë njëherë, se s'kemi kohë, nëse kemi parë. Do na vijë direkt tani dhe ne nuk e dimë çfarë është. Dhe ta shtyjmë për muajin tjetër.

**Ornildi Demollari:**Po s'kemi kohë ne. Mendoj se ka nevojë edhe për takim me publikun.

**Andonaq Risto:** Po. Se s'mund të vijë tani direkt edhe ne ta miratojmë. Të kemi kohë dhe ne ta shikojmë, ta studiojmë çfarë ka, çfarë ku do hyjnë. Faleminderit.

**Pranvera Begolli:**Edhe unë e mbështes kolegun. Aktualisht ne këtu kemi vetëm një projektvendim.

**Ornildi Demollari:**Tani e sollën atë projektvendim.

**Pranvera Begolli:**E sollën tani, pa unionin s'mund të ngrejmë dorën e të.

**Ornildi Demollari:**Mund ta kërkojmë ta fotokopjojmë dhe ta sjellim.

**Pranvera Begolli:**Jo. Ta lemë për një mbledhje tjetër. Do të miratojmë, do të miratojmë këtë që kemi.

**Faslli Zholi:**Është e ashtu në jetë, nuk e ka sekretari dokumentarisht dhe do ta lëmë për muajin tjetër.

**z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi:**Në fakt, kryetar edhe të nderuar këshilltar, bëhet fjalë për një sipërfaqe toke ku do vendosen dy aparatura për matjen e shpejtësisë së erës edhe është në parim. Pastaj do studiohet, është ngritur me urdhër të kryetarit. Jo, keni të drejtë, po që të jemi, nuk është se do vendosem përfundimisht.

**Nersida Shindo:**Është urgjente, duhet me patjetër sot. S'kemi kohë, asi.

**Faslli Zholi:** Unë e kuptoj se çfarë duhet bërë, po ajo do një lejë, do një dokument nga serviset neve këtu. Sepse pa e njohur kështu, pastaj bëjmë, shkojmë nga gabimi, nga gabimi bëjmë faj, pastaj dënohemi.

**z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi:**Në rregull, e lëmë për muajin tjetër.

**Ornildi Demollari:**Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës duke shtuar projektvendimin për festën e qershive në fshatin Kolanec. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.

Abstenim nuk ka. Miratohet rendi i ditës duke shtuar këtë projektvendimin që thashë. Më lejoni t'ju njoh me projektvendimet e mbledhjes së kaluar, të cilat janë kthyer në vendime tashmë. Janë gjithsej pesë me karakter normativ, të cilat kanë marrë dakordësinë e institucionit të prefekturës dhe janë kthyer në vendime tashmë, dhe pesë me karakter kolektiv, të cilat janë kthyer në vendime, por nuk kanë nevojë të shkojnë në institucionin e prefekturës. Ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar. Kush është dakord me protokollin? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet dhe protokolli i mbledhjes. Kalojmë tek, sipas rendit të ditës, kalojmë tek pika katër, e cila është projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin mars 2026. Ka ndonjë gjë këtu? Komisioni.

**Faslli Zholi:**Ka dy gjëra. Është në pikën katër për miratimin e ndihmave ekonomike. Ne dje, unë isha në komision duke u marrë vesh edhe me dy anëtarët e tjerë, të cilët ishin me mua, meqë ra dakord që, por jam në atë fjalën e asaj vajzës që komisionet duhet të marrin masa, të vijnë, këshilltarit të mos mungojë në komisione. Jam dakord që ndihmat të miratohen për ato që, siç i pamë dhe kartat dje. Faleminderit.

**Ornildi Demollari:**Ermanda, ke gjë këtu? Ka ndonjë pyetje, ndonjë koment tek pika katër? E kalojmë në votim. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet pika katër. Faleminderit. Kalojmë tek pika pesë, projektvendim për ndarjen e ndihmës financiare për familjet në nevojë. Komisioni?

**Faslli Zholi:**Edhe për këtë pikë i pamë ato familjet që mbase janë shumë në nevojë dhe mirë është që neve jemi të hapur edhe t'i ndihmojmë. Dhamë edhe një dy mendime atje, kam bërë dhe një dy pyetje në dokumentarisht. Të bëhet kujdes që ata qytetarë të shumtë që mund të kemi, ishallah s'kemi ashtu, po të jenë të dokumentuar, t'i drejtohen edhe organeve të tjera që neve të mos na marrin përsipër një diçka që ata kërkojnë. Kërkojnë, jam i sëmurë, do operohem apo do bëhem, dhe neve gjithmonë të jemi pronta. Unë jam katërcipriſht për të ndihmuar atë që ia vlejnë, po nuk kam asnjë kundërshtim për këtë. Do ta miratojmë, po të ketë kujdes në këto zhvillime, çfarë po kemi folur, që të bëhet kujdes në këtë.

**Ornildi Demollari:**Të bëhet kujdes, nuk e kuptova pas dot. Të bëhet kujdes në.

**Faslli Zholi:**Pyetja është sepse njerëzit kanë të tërë halle dhe unë jam operuar, ajo është operuar, ajo do shkojë në spital. Nuk mund t'i zgjidhi këshilli i bashkisë me fondet këto puna. Mund t'u drejtohen institucioneve përkatëse, përkatëse si dhe shërbimit social, si mbas sëmundjes, si mbas asaj, që të mos na bëhen barrë në këtë kuptim, le të na bëhen barrë se nëpër halle të qytetarëve, por të bëhet kujdes në këtë histori.

**Nersida Shindo:**Kjo është shumë e thjeshtë. Në qoftë se ata i plotësojnë kriteret, pikat që janë, është një.

**Faslli Zholi:**Këta pra janë duke thënë që të. Që të mos jetë rast pas rasti kjo punë. Jemi dakord që ato familje, ne i pamë edhe dokumentarisht, ta marrin këtë ndihmë, po të kenë kujdes.

**Ornildi Demollari:**Kemi ndonjë koment tjetër? Ndonjë pyetje? Nënkryetar? E kalojmë në votim, ju lutem. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika gjashtë e rendit të ditës. Projektvendim për ndarjen e ndihmës financiare për familjen e znj me inicialet F.XH, banuese, zonja, më falni, banuese në fshatin Veliternë, njësi administrative Pirg, banesa e të cilës u dogj si shkak i rënies së zjarrit. Komisioni? Nuk ka nga komisioni? Nuk ka nga komisioni.

**Faslli Zholi:**Unë kam një diçka këtu në këtë pikë. Se kemi miratuar dhe të tjera. Kjo është fatkeqësi e zjarrit, po a ka ndonjë përgjegjësi X shkaktari i kësaj? Është familjari se është i sëmurë? E ashtu. Apo është elektriku? Apo kush është në kjo histori? Sepse zjarri këtu, zjarri këtu, dhe nuk e kuptoj që duhet të dalë e të jetë më i përgjegjshëm dokumentacioni e më i ashtu për sa i përket këtyre zjarreve. Shkaku, shkaku, nga është shkaku? Të kemi ca. A ka dalë fajtori ku është burimi? Këtu desha të sqartësoja. Faleminderit.

**Ornildi Demollari:**Përgjegjësi i zyrës së emergjencës.

**Përgjegjës i Emergjencave Civile; z.Stiljan Belishta:**Përshëndetje. Atëherë është shqetësimi i këshilltarit, i nënkryetarit të këshillit, është i vërtetë. Problemi është që kur bëhet grumbullimi i dokumentacionit që do të plotësojë i dëmtuari, pikërisht një dokumentacion që kërkohet është dhe akt ekspertiza e MZSH-së, pra e shërbimit zjarrfikës, e cila përcakton shkakun i cili është i qëllimshëm ose jo i rënies së zjarrit. Ajo që bashkëlidhur në dokumentacionin e keni shkakun aty, ka qenë si rrjedhojë e një grabitjeje ku janë marrë dhe një shumë monetare prej 10 milionë lekësh dhe grabitësi njëkohësisht ka gjegur edhe objektin e banimit për të mbuluar gjurmët. Ajo që dua t'ju sqaroj në këtë pikë është se ligji i përmbrojtjes civile 145/2019 dhe VKM-ja, pra që përcakton procedurat për vlerësimin e dëmeve në rast se dihet një objekt banimi, kërkon jo shkakun e zjarrit, por kërkon natyrën e zjarrvënies. Pra, është zjarrvënie e qëllimshme ose jo, por edhe në qoftë se zjarrvënia është e qëllimshme, pra ndodh që është shmendur objekti, zotëria i, ose ka probleme të shëndetit mendor dhe i vendos zjarrin, përsëri ligji nuk e pengon institucionin e bashkisë që të bëjë dëshpërbimin në rast se bashkia gjithmonë ka kapacitetet dhe aftësitë financiare për ta bërë këtë gjë. Në rast se s'e ka, nuk e bën. Pra, si ishte ne na, duhet natyra e fatkeqësisë, pra lloji i fatkeqësisë që është zjarr, është përmbytje, është vullkan, është tërmetë, por nuk na duhet shkaku, por megjithatë aty bashkëlidhur e keni dhe shkakun, sepse është përcaktuar me akt të shërbimit zjarrfikës.

**Faslli Zholi:** E pashë zoti Stiljan atë, po e kam këtu më tepër problemin, se sa mirë e the që në qoftë se ka mundësinë ta bëjë këtë, në qoftë se ka. Ne flasim tani, ligji na ngarkon ne me këtë përgjegjësi ndaj këtij shkaku, që është ky fajtori që vajti dhe vodhi, bëri dhe këtë punë. A janë organet kompetente në atë që t'i çlyejë dikush a është kapur ky, sepse vjen viktimë gjithmonë, gjithmonë në këtë histori?

**Përgjegjës i Emergjencave Civile; z.Stiljan Belishta:**Jo. Ligji nuk na pengon neve që të bëjmë vlerësimin e dëmit në këtë rast dhe të dëshpërbëjmë të dëmtuarin. Këtë mund të citojmë, pra nuk na pengon, por nuk na detyron që neve të bëjmë dëshpërbëjmin. Është dhe kjo pikë. Në rast se neve kemi aftësitë financiare, e bëjmë. Në rast se s'kemi.

**Ornildi Demollari:**Faleminderit. Kemi një gjë tjetër? E kalojmë në votim atëherë.
Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika shtatë e rendit të ditës, që është projektvendim për ndryshim, për një ndryshim në buxhetin e bashkisë Maliq për vitin 2026. Komisioni i Financës
**Petrit Kupe:**Ky projektvendim bën fjalë për ndryshimet e zerave në buxhetin e miratuar në 2026-ën, pakësimi nga një fond dhe shtimi ose në shtimin e një fondi tjetër, duke cilësuar më saktë për ku do të përdoren këto fonde. Bëhet fjalë për 600 mijë lekë, të cilat do të përdoren për blerje makinerie kovës, zinxhira, për Eskarvatorë, me të cilin besoj është i domosdoshëm për bëjë zhvillimin e punës së bordit të prodhimit. Dhe 50 mijë lekë të përdoren për një konkurs rinor për promovimin e vlerave turistike të bashkisë Maliqit, nëpërmjet një konkursi video që do të paraqesin të rinjtë. Kështu që ne jemi ok për ta miratuar.
Faleminderit. Duke përfituar nga rasti, vazhdojmë edhe me projektvendimin tetë.

**Ornildi Demollari:**Kur të shkojmë aty, Petrit, që t'i marrim me radhë.

**Petrit Kupe:**Më e mirë. Dakord.

**Ornildi Demollari**:Ka gjë tjetër në këtë nga kolegët? Nënkryetar?

**z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi:**U sqarua nga këshilltari.

**Ornildi Demollari:**Drejtoreshë, është e sqaruar. E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Pika shtatë. Faleminderit. Kalojmë tek pika tetë. Projektvendim për përdorimin e fondit për mbrojtjen civile nga buxheti i shtetit.
**Petrit Kupe:**Po, bën fjalë për përdorimin për emergjencat, për rastin e dëmtimeve të kryera në periudhën e reshjeve intensive, në një vlerë prej 13 milon e 606 mijë lekë, për të cilin jemi dakord të përdoren në ato zona të cilat janë dëmtuar nga emergjencat. Këto kishim.

**Ornildi Demollari**:Po, faleminderit. Kemi një gjë tjetër këtu? Eri, kemi një gjë këtu? Kjo ka nevojë për më shumë shpjegim.

**z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi:**Në qoftë se ka nevojë për më shumë shpjegim, bëhet fjalë për furnizuesin e rezervuarit që vjen nga Vërçuni.

**Ornildi Demollari**:Po se është goxha sensitive për.Për fermerët.

**z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi:**Po, për fermerët, por bëhet fjalë edhe në pjesën e reshjeve që uji, që vjen nga prurjet që sjell ujëshqyesi, derdhet në tokat e fermerëve të fshatit Kakaç dhe e kemi parë si emergjente për t'u ndërhyrë tek ajo pjesë e dëmtuar. Gjithashtu, bëhet fjalë edhe për një urë kalimi në fshatin Osojë. Është menduar që të vendosen tombino 1200, në mos gaboj, sipas specialistëve që kemi ne, për të bërë të mundur kalimin aty, sepse ishte e pamundur të themi që bashkia të mundësonte financiarisht ndërtimin e një ure. U mendua teknikisht që edhe vendosja e tombinove të bëjë të mundur kalimin e banorëve dhe funksionimin e atij aksi rrugor, që ka qenë vërtetë problematikë.

**Ornildi Demollari**:Faleminderit. Dua të ndalem pak këtu, duke marrë shkak që u përmendën fermerët. Kam marrë një shqetësim, e kam marrë nga fermerët e zonës së Pojanit, po që jam i bindur që nuk ka të bëjë vetëm me fermerët e zonës së Pojanit, ka të bëjë me të gjithë fermerët e të gjithë bashkisë dhe ka të bëjë me tufat e bagtive që kullosin nëpër fushë dhe dëmtojnë të mbjellat. Desha ta ndaja me këshillin këtë. Mbase do të duhet të shikojmë ndonjë mundësi ose ndonjë se si mund ta parandalojmë këtë problem.

**z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi:**Keni të drejtë, është këshilli ka marrë një vendim në vitin 2016 për largimin e bagtive nga zonat e banuara dhe është vendosur, janë vendosur edhe vlerat e gjobave për bagtitë që kullosin në fushë. Kërkon angazhim edhe të qytetarëve, them, po edhe një angazhim tonin më të theksuar, por duhet edhe një bashkëpunim me qytetarët për të bërë të mundur realizimin e kësaj pune, se ka ndodhur që në momentin që janë kapur blektorët në dëm në tokat e fermerëve, disa nga bujqtë me të drejtë mbase e kanë hequr atë peshën e denoncimit nga vetja e tyre, që në tokat private duhet edhe një mbështetje e qytetarëve për të bërë të mundur që problemi të adresohet siç duhet në institucionet tjera, siç janë policia apo prokuroria, që të jepet rëndësi e veçantë. Edhe besoj me të drejtë e keni ngritur këtë shqetësim e të gjithë këshilltarët. Mendoj që çdo ditë e hasin këtë, se ne jemi të gjithë nga zona rurale dhe bashkia tonë është një bashki me shtrirje të gjerë në zonat rurale. Është problem që kërkon zgjidhje. Ne patjetër që me strukturat tona do japim maksimumin në angazhimin tonë, por kërkon edhe një bashkëpunim më të gjerë kjo pjesë. Mbase duhet të mendohet edhe në këshill për një rëndim edhe të masës administrative të gjobave, se ato deri diku janë edhe simbolike, me sa kam parë tek ai vendimi i këshillit të vitit 2016. Mbase ka ardhur koha që të rishikohet edhe njëherë vendimi i këshillit.

**Nersida Shindo:**Mendoj që rolin kyç e kanë edhe kryepleqtë, meqenëse kemi dhe kryeplakun këtu të Trovës.

**Ornildi Demollari**:Po.

**Armando Dautllari:**Nuk është problemi, sepse unë kam parë shumë veta që ata i denoncojnë, por problemi është në qoftë se dëmi është nën 300 mijë lekë, policia nuk merr dot masë atje.Edhe

duhet ta bëjmë ne, duhet t'i dhëmbë gjobat ne më të rënda, sepse ti vë një gjobë 3000 lekë aty. Çfarë atij sipër fare përshtypet 3000 lekë?.Pesë herë asgjë s'i ka bërë

**Ornildi Demollari**:Vazhdojmë me rendin ditës. Është një çështje që ka nevojë për tur i parë. Ne duhet të ndalemi pak në bashkëpunim, ndoshta me ekzekutivin për ta mbyllur këtë si gjë, që t'ia u heqim këtë problem fermerëve dhe t'i lëmë me sfidat e përditshme që ata kanë, po të paktën t'ju heqim këtë hallin me bagtitë. Faleminderit.

**Faslli Zholi:**Këshilli tha është zarar kjo se njëherë që ka 300 tufa, ne na duhen edhe këto tufa. Duhet të zgjidhemi me këtë paketën e mbledhjeve.

**Ornildi Demollari**:Ju lutem, jemi tek pika tetë. E kalojmë në votim pikën tetë, ju lutem. Apo ka ndonjë pyetje tjetër? Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Kalojmë tek pika nëntë e rendit të ditës.

**Petrit Kupe:**Siç duket, vazhdojnë efektet e reshjeve, të përmbytjeve dhe një sipërfaqe e konsiderueshme nuk rrezikohet të mos mbillet për vitin 2026 dhe kjo ka bërë që bashkia të marrë, të paraqesë projektvendim për lehtësimin e pagesës së taksës të atyre sipërfaqeve të cilat nuk mund të mbillen prej këtij viti. Është përcaktuar aq sa e lejon dhe ligji, në masën 75%. Fermerët që nuk do t'i mbillin do paguajnë 75% të taksës për këtë vit. Për më gjerë, le të flasë edhe drejtori i bujqësisë.

**Ornildi Demollari**:Po, dhe projektvendimi është që për lehtësimin e përkohshëm nga detyrimi i taksës, i pagesës së taksës së tokës bujqësore për familjet bujqësore, tokë e cila është përmbytur dhe është bërë e pamundur për t'u shfrytëzuar gjatë vitit bujqësor 2026 nga dëmtimet e forcave madhore të natyrës. Drejtori i agjencisë.

**Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë;z.Aurel Zenunllari:**Ky propozim është sigurisht me iniciativën e kryetarit. Sektori i bujqësisë ka përgatitur propozimin për në këshill për lehtësimin e përkohshëm vetëm për vitin 2026, pasi e ka parë të pamundur që këto toka të shfrytëzohen për këtë vit bujqësor, sepse ndodhen ende nën ujë. Bëhet fjalë kryesisht për zona torfike. Janë të përfshira tre fshatra që mund të themi që përfitojnë këtë ulje, siç e parashikon dhe ligji, në masën 75% të taksës bujqësore. Kaq.

**Ornildi Demollari**:Dakord.Faleminderit. Ka ndonjë pyetje tjetër? Ka ndonjë gjë të paqartë këtu? Nënkryetar? E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Dhe e kalojmë tek pika dhjetë e rendit të ditës. Projektvendim për miratimin e përfituesve nga programi "Subvencionimi i interesave të kredisë për strehimin". Komisioni? Përgjegjësi i zyrës së strehimit? Apo ka ndonjë pyetje nga kolegët? Ka ndonjë paqartësi nga kolegët përpara se të flasë përgjegjësi? Urdhëro.

**Përgjegjës i Zyrës së Strehimit; z.Ledion Mullalli:**Po. Është një familje, është një familje. Është një familje e cila plotëson kushtet e strehimit, kushtet familjare dhe kushtet sociale që parashikon ligji. Është një familje e cila përfiton 60% të vlerës së apartamentit, pasi ka një banesë nën normat e strehimit dhe në bazë të ligjit ajo përfiton 60% të vlerës së kredisë për apartament 3+1. Ne sapo kemi hapur dhe thirrjen për aplikimet e reja, të cilat e cila gjendet në faqen e bashkisë dhe në të gjitha stendat e bashkisë dhe janë të gjitha informacionet e nevojshme për dokumentacionin dhe procedurat të cilat ndiqen në këto raste.

**Ornildi Demollari**:Faleminderit. Ka ndonjë pyetje këtu?.Po, mungon materiali. Mungon një pikë. E kalojmë në votim. Kush është dakord, ju lutem? Ju lutem të votojmë, kolegë. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Dhe tani bëjmë një kapërcim, kalojmë tek, kalojmë se kemi projektvendimin për fshatin Kolanec dhe pastaj ecim sipas rendit, se nuk janë projektvendime. Atëherë, projektvendim për miratimin e kërkesës së banorëve të fshatit Kolanec dhe organizimin e aktivitetit kulturor "Festa e Qershive". Ka erdhur si kërkesë e banorëve dhe ekzekutivi e ka sjellë si dokument për miratim.
**Petrit Kupe:**Po, është viti i dytë që organizohet kjo festë dhe normale banorët kanë kërkuar që të jetë në vëmendjen e bashkisë për organizimin e kësaj feste dhe për përballimin e shpenzimeve. Kemi biseduar me financën dhe është në kuadër të fondit që ka lënë bashkia për festat që kryhen gjatë vitit në territorin e bashkisë. Ne jemi dakord që të shtohet dhe kjo festë zyrtarisht. Dakord.

**Ornildi Demollari**:Faleminderit. Ka ndonjë?

**Pranvera Begolli:**Ka vetëm një shtesë. Aktualisht nuk është preur vlera që do përdoret për këtë festë.

**Ornildi Demollari**: Nënkryetar?

**z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi:**Siç e tha dhe zoti Kupe, është një iniciativë e banorëve të fshatit Kolanec që kjo festë është realizuar edhe vitin e shkuar dhe e ka patur një sukses përsa i përket realizimit edhe pjesëmarrjes. Qëllimi i bashkisë është që ne të promovojmë zonat tona të bukura malore. Aty, tek projektvendimi që ju ka erdhur, e keni asistencën që kërkojnë banorët nga institucioni tonë me bazë materiale dhe me nga pallati jonë i kulturës për pjesën e realizimit artistik, kurse detajet e detajet e vlerave financiare që do kërkojnë ata, mbase duhen diskutuar edhe me financën, po nuk e shkoj që aty të kërkojnë vlerë monetare ata. Edhe kërkojnë vetëm asistencë teknike edhe. Po, të jetë edhe data të zyrtarizohet si festë e asaj e atij fshati. Po, po të kërkojnë pastaj juve do ta shikoni edhe do ta analizoni.Fondi i festave në total, po nuk është se, po nuk është se ju do ta përcaktoni pastaj komisionet, do ta shikoni të arsyeshme që si do t'i shpërndani këto fonde në festa. Unë sugjeroj që të kemi sa më shumë festa për të promovuar.

**Faslli Zholi:**Është një për këto festat, është gjë e mirë kjo që është iniciativë e Kolanecit, kështu të bëhet edhe në çdo fshat po të ketë mundësi dhe gjë e mirë që ata nuk kërkojnë investim, po ato pak investime që janë mendohet që le t'i shpërndajmë edhe është tjetër ajo. Po kolanecit, meqë di unë, atë rrugën nuk e di se deri ku është, se është edhe këtu afër, duhet të përmirësohet ajo rruga, të bëhet ajo rruga, se është, ju e dini mirë, të tjerët e dinë që është pranë bashkisë.

**Ornildi Demollari:**Të gjithë duan, të gjithë duan. Shumë duam që të bëhet. Kemi gjë tjetër? E kalojmë në votim atëherë. Kush është dakord? 16 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka. Miratohet. Faleminderit. Tani jemi tek pika 11, analiza e zbatimit të buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2025. Drejtoreshë, duhet të ulesh në një karrige me mikrofon që të flasësh, të lutem. Pse erdhe mbrapa? Më ti, hajde ulu. Hajde ulu në karrige me mikrofon që në fillim. Aurel, Aurel, mos u largo. Po?

**Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka:**Përshëndetje të gjithëve. Analiza e zbatimit të buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2025 është një detyrë ligjore sipas ligjit 9936 datë 26. 06. 2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, udhëzimi i Ministrisë së Financave, bazë që është numër dy. Prandaj ne, bashkë me Drejtorinë e të Ardhurave, kemi përgatitur një material. Kur themi buxhet, i parashikojmë shpenzimet dhe të ardhurat. Tani të gjithë jeni njohur me materialin, po jap shkurtimisht disa detaje dhe pastaj qartë t'ju lëjmë pyetje. Mund ta shohim. Bashkë si këshill me ekzekutivin dhe këshillin kemi miratuar buxhetin e vitit dhe tani po japim detajet për realizimin e tij. Gjatë periudhës dhjetor-janar kemi punuar për të realizuar të gjitha detyrat që na janë ngarkuar si Drejtori i Financave dhe të Ardhurave. Të ardhurat e bashkisë, plani 12-mujor ka qenë 300 milionë 050 mijë dhe fakti është 186 milionë 231 mijë. Realizimi 62%. Do më falni se në atë materialin që keni, kjo tabelë e parë është bërë një lapsus dhe po të shikoni të ardhurat që janë zë më Zë, në fund është kjo vlera 186 231. Në fund të. Të tabelës. Është kjo vlera e realizimit të të ardhurave dhe është bërë dhe krahasimi 2024 me 2025 që kemi një rritje. Në 2025-ën realizimi është 62% e planit. Tani atje janë të specifikuara të ardhurat tatimore, jo tatimore sipas zërrave. Besoj i keni parë në me detaje, po ashtu dhe i lexoj. Për sa i përket realizimit të shpenzimeve, gjithsej plani vjetor, kur bëhet realizimi i buxhetit, kemi buxhetin që miratojmë ne si këshill, kemi dhe të ardhurat që na vijnë nga Ministria për Paftësinë, për Ndihmën Ekonomike, për investimet dhe prandaj buxheti si plan vjetor është 1 miliard 493 milionë e 607 mijë. Realizimi vjetor është 1 miliard 288 milionë 260 mijë dhe realizimi total si në përqindje është 86%. Si plan vjetor me faktin dhe më poshtë kemi nxjerrë ku janë mosrealizimet që kanë ngelur. Shpenzimet për paga dhe sigurime 91% të realizimit. Shpenzimet operative 78% dhe projektet janë realizuar 62%, investimet 72% të buxhetit. Në tabelën keni të gjitha investimet, se zakonisht pagat do miratohen struktura dhe detyrimisht pagat do realizohen, sigurisht dhe detyrimet për sigurime shoqërore dhe kemi vendosur realizimin e investimeve sipas objekteve ku kemi bërë shpenzimet. Disa mund të dalin dhe mosrealizime, po kemi dhe objekte të cilat janë edhe 3-vjeçare, siç janë sistemim asfaltim rrugësh, në njësitë administrative që i kemi. Që s'kanë përfunduar 25, 26, 27, se janë futur në buxhetin e. Ndonjë mosrealizim për investime të cilat nuk është realizuar, është edhe kjo

mosrealizimi i të ardhurave, se edhe kjo ndikon në ecurinë. Ato detyrime që i kemi nga 2025-ta janë futur në buxhetin e vitit 2026 dhe këtë parashikim i është bërë jo nga të ardhurat, që të jetë më i sigurt është bërë parashikimi nga grandi që ka sjellë qeveria. Kemi. Që të këto të detyrimisht duhet të likuidojnë brenda këtij viti. E kanë dhe ligjin për detyrimet e prapambetura, i cili duhet patjetër të mbyllen ato të vitit dhe pastaj të vazhdohet me këto të vitit në vazhdim. Pastaj kemi më poshtë, kemi një analizë të treguesit financiar, duke vendosur raporte ndërmjet sa zen investimet ndaj buxhetit të përgjithshëm, sa zen realizimi i të ardhurave ndaj buxhetit, me sa shikojmë një analizë të buxhetit, grante që vijnë nga qeveria zen pjesën më të madhe në të cilat mbështetet bashkia jonë, sepse pjesën e të ardhurave fakt plani është, por realizimi i mosrealizimit të ardhurave ka edhe arsyet e veta, largimi i njerëzve nga ato dhe janë detyrimet prapambetura të cilat janë ndër vite, pavarësisht se ato janë ne i kemi të ardhura për t'u mbledhur, por fakti është se ato nuk.Dhe e njeh dhe ligji që 18 muaj duhet patjetër të bëhet planifikimi i këtyre sikur do mblidhen, pastaj sa realizohet kjo varet nga të gjithë ne. Detyrimet e prapambetura, edhe kjo është një sfidë që ka bashkia tonë, këtë vit i kemi në rritje, po ta krahasojmë me vitin e kaluar, janë 75 milionë. Në detyrimet e prapambetura futen të gjitha faturat të cilat janë pa likuiduar mbi 60 ditë sipas udhëzimit dhe ligjit të buxhetit dhe këto dalin pastaj i keni të specifikuara ku janë këto detyrime sipas objekteve. Tani është prerë fatura dhe nuk kemi patur mundësi financimi dhe të gjitha këto, se në fund të vitit ne bëjmë edhe në ministri bëjmë raportim për detyrimet e prapambetura dhe për të gjitha këto është të planifikuar që këtë vit të realizohen patjetër. Ne kemi filluar për detyrimet që i kemi likuiduar, këtë do ta japim në raportin e monitorimit që do miratojmë në maj dhe do dalin këto detyrimet në edhe këto janë në të gjitha objektet ku i kemi këtë mosrealizim.Një sfidë tjetër vitin e kaluar ka qenë dhe që kemi patur dhe agjencinë e shërbimit publik që u nda dhe me sa u pa dhe ajo e arsyeshme prapë nuk pati funksion, po këtu kemi bërë dhe analizën. Ajo ka patur më shumë si agjenci, ka patur të gjitha detyrimet për paga, sigurime dhe shpenzime operative, blerje të vogla, kurse për investimet i ka mbajtur peshën bashkia dhe ato janë realizuar të gjitha. Të gjitha aktiviteti i agjencisë së shërbimit publik, domethënë është realizuar gati 100% me një detyrim shumë të vogël të cilat kanë kaluar për vitin 2026 në bashki. Një problem që del për këtë vit, domethënë është gjithmonë ne ngelemi në realizimin e investimeve sa më shumë për në ndihmë të komunitetit, por kjo kërkon edhe angazhimin për grumbullimin e të ardhurave që këtu e kemi duke filluar që nga ne punonjësit deri në ata fermerët të cilët janë. Këto kisha unë.

**Ornildi Demollari**:Mirë drejtoreshë, faleminderit. Kemi ndonjë pyetje?

**Petrit Kupe:**Kisha unë një pyetje, është miratuar një preventiv për kalimin e një pjese të taksave vendore për nxehtësinë, çfarë po bëhet? Dua ta dimë se ka disa muaj që kemi miratuar dhe nuk po shohim që të vihet nga Ujësjellsi kjo taksë. Se duket si një rrugë mjaft e efektshme për rritjen e të ardhurave, duke pasur parasysh që ato nuk realizohen aq sa ç'duhet. Mund të na thotë?

**Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka:** Unë me sa jam në dijeni se këtë e ka drejtoria e të ardhurave më shumë, po listat janë bërë gati për vitin 2026, po po prit, nuk po bien dakord për marrëveshjen me Ujësjellsin për atë përqindjen që do na mbajnë ata. Shërbim është

2%. Tarifën që do na bëjnë ata, domethënë ata ne i kemi rënë dakord me 2%. Ata pretendojnë me 3% dhe duhet të marrin miratimin nga Drejtoria e Tiranës edhe këtu kemi ngelur.

**Faslli Zholi:**E ndan përzgjedhjen agjendës tatimore me Ujësjellsin.apo me OSSHE?

**Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka:**Me Ujësjellsin.

Mirë. Gjë tjetër kemi? Mirë, faleminderit, atëherë kemi edhe një pikë tjetër këtu tek. Është njoftim për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të bashkisë Maliq për të vitit 2025. Mund të na thoni diçka edhe për këtë?

**Petrit Kupe:** Ne e pamë si komision, por jemi dakord që po bëhet një punë e mirë dhe vitin e kaluar e këtë vit për shkarkimin e materialeve të cilat janë jashtë përdorimit dhe janë nëpër magazina duke zënë vend kot dhe ky komision i ka vlerësuar dhe jemi ok që të nxirren në momentin e mëparshëm jashtë përdorimit kundrejt të gjithë rregullave. Nuk është vendim, por është një informacion.

**Ornildi Demollari:**Jo, nuk është projektvendim, ja po e shihni. Është informacion, po. Drejtoreshë, mund. Nëse është e shikon të nevojshme.

**Drejtore e Financës dhe Buxhetit:znj.Almira Muka:**S'ia di çka, sipas udhëzimit 30 duhet që më përpara ka qenë që këshilli merrte vendimmarrje për këtë.

**Ornildi Demollari:**Dakord. Mirë. Materialin e kemi marrë, e kemi parë. Mirë, faleminderit. Atëherë tani kemi disa kërkesa, po njëra ishte kjo e fshatit Kolanec, të cilën ne e kaluam. Tani kemi një ankesë kërkesë drejtuar bashkisë Maliq, thotë nga Sulejman Qemalaj, Drithas Libonik, i cili ngresh, ankohet sepse gjatë rreshjeve që kanë që kanë rënë toka e tij është dëmtuar, ka shkarrë dheu dhe është bërë e papunueshme, thotë. Megjithëse zoti Qemalaj është në sallë, në mos gaboj, edhe ia japim fjalën të na i shpjegojë më mirë, por shoh që kjo nuk është tamam, tamam për këshillin, nuk është kompetencë e këshillit. Aurel, mund të na shpjegosh diçka për këtë? Po. Kërkoj dëmshpërblim, thotë zoti Sulejman, sepse situata ime është shumë problematike dhe më është bërë një dëm i madh, thotë.

**Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë;z.Aurel Zenunllari:**Sektori i bujqësisë është njohur me ankesën e zotërisë. Është situata, është vërtetë e vështirë për një pjesë të parcelës së zotërisë, sepse ka dalë pothuajse jashtë përdorimit për shkak të rreshjeve të nëntorit të vitit të kaluar. Sigurisht, nuk është kompetencë e këshillit. Për këtë arsye, bashkia ka filluar të ndjekë hallkat një pas një për të verifikuar dëmin dhe për të marrë masa për riparimin në rast se do të mundet të riparohet. Është në dijeni sektori i bujqësisë, sektori i ujitjes dhe kullimit për këtë çështje. **z/v.Kryetari i Bashkisë;z.Eridon Rustemi:**Shqetësimi që ngre zotëria nga fshati i Sheqeras është se nga Sheqerasi, në Sheqeras është problemi, është pikërisht vendi ku pati çarje, argjinatura e lumit Devoll dhe i gjithë materiali që u vendos në argjinaturë është marrë tek

parcela e zotërisë. Është një problem me vend. Unë e kam vënë në djeni zotërinë edhe për këtë projektvendimin e sotëm që për lehtësimin e masës deri në 75% nga taksat e bashkisë. Jemi duke e vlerësuar si problem, ashtu siç tha edhe përfaqësuesi i sektorit të bujqësisë në bashkinë e Maliqit. Ne me strukturat tona dhe me mundësitë tona do mundohemi ta rikthejmë atë parcelë në gjendjen e mëparshme, por shqetësimi duhet vlerësuar dhe ne do ta ndjekim hap pas hapi, sepse ajo nuk kthehet brenda një viti apo brenda dy vitesh në gjendje për t'u rimbjellë. Ka dhe shumë të drejtë dhe do ta ndjekim me përparësi për sa na takon edhe për sa na ngarkon ligji.

**Ornildi Demollari**:Faleminderit. Dakord, zoti Sulejman, në rregull. Zotëria tjetër. Ngjitur tani. Për të njëjtin problem jeni. E njëjta përgjigje. Zotëria atje?

**Faslli Zholi:**Është që unë kam një diçka se në lidhje me Axhiun. Axhiu ka bërë një kërkesë këtu, nuk e di se paska ardhur dhe ka protokolluar. Meqë shikoj unë, ka një të drejtë atje meqë edhe ti, zoti në kryetar këtu i ekzekutivit, ajo është problemi edhe bashkia mund ta zgjidhi se është nyja, mund ta shpjegojë shumë mirë vetë atje, por ky vetë edhe shpice, ka shpite të gjata në fshat dhe rrinë në liponi. Mos ketë ujë për të pirë atje, kjo nuk është normale. Kur uji të kalon atje, edhe sepse e kemi zënë si ajo kuçedra, dhe problemi i tij është fare i thjeshtë që atje ti lënë tentë, marri ujë dhe nuk dua shpenzim asgjë, po ti jepet e drejta që të marri ujë. Se nuk mund të ketë njeri në republikën tonë apo kudo që të mos marri diell, mos marri dhe ujë. Sepse është mundësi aty. Ajo ka pengesa atje, Axhiu mund ta sqarojë më mirë.

**Ornildi Demollari**:Dakord, do ta shikojmë.Në rregull, do ta e morëm shqetësimin, do ta shikojmë. Zonja atje në fund, riulur, s'ka gjë.

**Qyetarja:**Unë kam 3 fëmijë të shtëpisë. Dy kanë me të veta me ndarë dhe një kam me të punë këto. Nuk jetë dua. Atje që s'kanë parë. Kam bërë ankesë, kam mbajtur grupkat ata, më ka drejtuar në bashki, në komunë. Ka të drejtë të marrë policia, bashkia edhe të heqë. Fatjoni më. Kam bërë edhe këto kam dërguar. Kam dërguar, e morën këtu.Unë e kam bërë kërkesën. Po bëjmë një, dy javë a më shumë këtu. Duhet ta ketë.

**Ornildi Demollari**:Mirë. Dakord, do ta shikojmë. Ja do vijë ajo vajza që është kompetente për atë punë edhe do të ndihmojë.Ja shko me atë vajzën, ja ku erdhi ajo vajza, ik me atë vajzën.Dakord. Në qoftë se s'kemi gjë tjetër, tek diskutime të tjera po.

**Faslli Zholi:**Një problem që besoj se i shqetëson të gjithë fshatrat dhe komunitetin e bashkisë që shikoj unë, Eri. Unë bisedova sot edhe me atë shefin e policisë të bashkisë. Shikoj në çdo fshat ka makinat lënë në rrugëve që i kanë marrë për vegla, për gjëra të lënë për të shitur dhe me vend e pa vend. Edhe ky është ankim edhe nga zjarrfikëset, është ankim edhe nga makina e plehrave. Dhe tjetër gjë që dua të theksoj këtu në këshill, kjo më shtyn më shumë, duhet të kërkohet një çikë llogari këtyre kërpleqëve, sepse e kam thënë edhe disa herë të tjera, në dëgjesat, mbushen kazanët me inerte, me gjëra që nuk janë në stacen e plehrave dhe ne duam që të kemi një lagje të pastër, një rrugë të pastër, një qytet të pastër. Këtu kemi edhe pashë shumë mirë që kishte bërë

bashkia pas Devollit bëjnë një pastrim. Duhet të ushtruar edhe kontroll edhe nga ana e ekzekutivit edhe kërplejtë të lëvizin çikë më shumë, se tani të erdhuan të zgjedhur janë ata si ne, marrin ato dy lekë aq sa marrin, po të paktën të dalin njëherë në rrugë, në lagje ku janë kazanët, mbushen kazanët me kallama mistrishta, mbushen kazanët me barna, mbushen kazanët me krasina që krasinë. Kjo nuk është e drejtë dhe të heqin prej hop, pa futur pastaj edhe madje dhe pleh ka familje që të cilët e nxjerrin edhe mund ta hedhin edhe në kazani. Që kjo se kazanët janë shumë mirë, po të bllokosh edhe makinat pastaj të kësaj natyre ka në çdo rrugë, po t'i kreni, kur flas, flas edhe për në Pirg, flas edhe për këtë që i lënë në rrugë edhe i kanë bërë. Kjo duhet të merret me policinë bashkiake të rregullohet kjo, të pastrohet, sepse nata sjell edhe papritur e njëjta gjë, s'mund të dali, rruga është e bllokuar, hyrja është e bllokuar nga makinat të cilat nuk janë në funksion. Këtë e kisha si shqetësim dhe me kërplejtë e kam shumë këtë histori. Për këto desha. Mirë, faleminderit.

**Ornildi Demollari**:Tek diskutime tjera kemi gjë tjetër? Në qoftë se nuk kemi diçka tjetër, kjo ishte mbledhja.Ditë të mbarë.Faleminderit!

**Mbajtës Protokolli**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**

**Gertjan GJIRITI**

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Ornildi DEMOLLARI**